

# ANALIZË KRAHASUESE

**Përmbledhje nga puna e kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit  
(Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash, Mamushë)**





**PERSONELI:**

Ismet KRYEZIU - *Drejtor Ekzekutiv*  
Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*  
Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*  
Arsim GJINOVC I - *IT & design*

3

**PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:**

Kreshnik Basha - *Menaxher programi*  
Driton SELMANAJ - *Asistent i programit*  
Isuf ZEJNA - *Monitorues*  
Besnik RAMADANAJ - *Monitorues*  
Liridon SELMANI - *Monitorues*

**PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE**

Naim CAHANAJ - *Koordinator*  
Ramadan KLISURICA - *Koordinator*

**PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI**

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*  
Esat MAZREKU - *Koordinator*  
Enis XHEMAJLI - *Lead Researcher*  
Natyra KASUMAJ - *Assistant Researcher*

## Përmbajtja

4

Hyre .....	5
(Mos)Respektimi i ligjeve dhe monitorimi i MAPL-së .....	6
• Roli i MAPL-së .....	6
• Kapacitetet e MAPL-së.....	6
• Shkeljet ligjore të evidentuara në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit .....	8
• Arsyet e shkeljeve.....	9
• Çka duhet bërë?.....	9
Puna e kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit.....	11
• Përmbledhje nga seancat.....	12
- Prizren.....	12
- Suharekë.....	14
- Rahovec.....	15
- Malishevë.....	16
- Dragash.....	17
- Mamushë.....	18
Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje.....	19
• Sfidat e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.....	20
Realizimi i buxheteve komunale në gjashtë mujorin e parë 2010.....	22
- Shpenzimet e komunave në gjashtë mujorin e parë 2010.....	23
- Të hyrat e komunave në gjashtë mujorin e parë 2010.....	24
- Bilanci gjashtë mujor i komunave.....	25

## Hyrje

**N**ë kuadër të funksionimit të qeverisjes së mirë në nivel lokal, rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe sigurimit të transparencës me punën e institucioneve të vetëqeverisjes lokale, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në vazhdimësi bënë monitorimin e punës së gjashtë kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit.

Monitorimi i KDI-së është në funksion të vlerësimit periodik të punës së përfaqësuesve të qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit dhe të subjekteve politike të përfaqësuara në to. Dimensioni tjetër i punës së KDI-së është edhe hartimi i raporteve periodike krahasuese mbi çështje të rëndësishme të sistemit të vetëqeverisjes lokale në këtë regjion.

Me anë të kësaj analize, synohet që qytetarit t'i paraqitet një përmbledhje rreth raporteve të kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit me organin mbikëqyrës në këtë rast Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kompetencave të institucioneve lokale dhe punës së bërë prej tyre në fushën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, punën e kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit në periudhën Korrik - Shtator 2010 dhe proceset buxhetore nëpër komuna.

Njëkohësisht, "Analiza krahasuese" është planifikuar të jetë periodike me anë të së cilës parashihet që në çdo katër muaj të bëhet një analizë mbi zhvillimin e politikave në institucionet e vetëqeverisjes lokale si edhe krahasimi i këtij zhvillimi qoftë mes komunave, qoftë mes periudhave.

## (MOS)RESPEKTIMI I LIGJEVE DHE MONITORIMI I MAPL-SË

### • Roli i MAPL-së

Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat. Ato obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore<sup>1</sup>. Andaj, me qëllim të themelimit të bazës ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror<sup>2</sup>.

Po sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, autoritet mbikëqyrës për qeverisjen lokale është ministria përkatëse<sup>3</sup>, në këtë rast Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ligji në fjalë në mënyrë koncize dhe të gjerë i trajton marrëdhëniet në mes pushtetit lokal dhe atij qendror. Pjesë e këtij trajtimi janë aspekte që nisin me forcimin e aftësisë së organeve të vetëqeverisjes lokale në përmbushjen e përgjegjësive të tyre përmes këshillimit, mbështetjes dhe ndihmës e deri tek njoftimi i Qeverisë me jo funksionalitetin e kuvendit të komunës apo edhe dërgimi i rekomandimit në Qeveri për shkarkim të kryetarit të Komunës. Në këtë aspekt, roli i MAPL-së është crucial në drejtim të përmbushjes së synimit për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale.

### • Kapacitetet e MAPL-së

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokale është themeluar më 04.12.2004. Sot ajo funksionon në pesë departamente të ndara me gjithsej 97 zyrtarë. Një nga departamentet e MAPL-së është edhe Departamenti për Vetëqeverisje Lokale. Ky departament përbëhet nga:


- Divizioni për planifikim dhe analiza;
- Divizioni për të drejtat e njeriut;
- Divizioni për vlerësim të performancës;
- Divizioni për monitorim të shërbimeve komunale;
- Divizioni për ngritjen e kapaciteteve në komuna<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 124.

<sup>2</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 2.

<sup>3</sup> Po aty, Neni 76.

<sup>4</sup> <http://www.mapl-ks.org/?cid=1,103>



Ndër shtatë objektivat kryesore të MAPL-së, menjëherë pas themelimit të saj, ka qenë edhe përkrahja, monitorimi dhe mbikëqyrja e kompetencave të komunave për të siguruar se është duke u zbatuar ligjshmëria. Megjithatë, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, MAPL ka bërë rishikimin e misionit dhe objektivave të saj. Ky rishikim ka bërë që përkrahja, monitorimi dhe mbikëqyrja e kompetencave të komunave për të siguruar se është duke u zbatuar ligjshmëria, të mos jenë ndër objektivat kryesore të MAPL-së<sup>5</sup>.

Në nëntor 2008 është publikuar Strategjia Afatmesme e Punës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 2009-2012. Në këtë dokument MAPL ka përmbledhur aktivitetet të cilat do t'i ndërmerret kjo Ministri me qëllim të përsosjes së funksionimit, promovimit dhe afirmimit të pushtetit lokal në Republikën e Kosovës. Pjesë e këtij dokumenti është edhe Analiza e vetëqeverisjes lokale, e cila bënë një përmbledhje të përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve të sistemit të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj, si një ndër rreziqet e mundshme për sistemin e vetëqeverisjes lokale përmendet edhe kujdesi i pamjaftueshëm i pushtetit qendror për pushtetin lokal.

<sup>5</sup> <http://www.mapl-ks.org/?cid=1,4>

• Shkeljet ligjore të evidentuara në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

8

Shkeljet ligjore të kuvendeve të komunave gjatë vitit 2010.

Ligji	Neni	Komuna	Data	Çështja
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 42	Prizren	15.02.2010	Konstituimi i Kuvendit të Komunës
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 35.5	Prizren	15.02.2010	Dhënia e betimit
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 42.5	Malishevë	08.01.2010	Kryesimi i seancës inauguruese
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 35.5	Malishevë	29.01.2010	Dhënia e betimit
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 50.2, pika a)	Rahovec	12.02.2010	Zgjedhja e Kryesuesit
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 60	Prizren	3.2010	Nënkryetari
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 44.4	Prizren	07.04.2010	Informimi i publikut
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 43	Prizren	26.04.2010	Informimi i publikut
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 68	Mamushë	30.04.2010	Konsultimi publik
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 53	Mamushë	30.04.2010	Komiteti për komunitete
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 41.1	Rahovec	05.05.2010	Seanca e jashtëzakonshme
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 47	Rahovec	26.05.2010	Rendi i ditës
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 43.1	Rahovec	26.05.2010	Mbledhjet e Kuvendit
Ligji për Arsimin në Komuna	Neni 5, pika d)	Malishevë	Në vazhdimësi	Kom. për zgjedhjen e drejt. të shkoll.
Ligji për Arsimin në Komuna	Neni 5, pika d)	Suharekë	Në vazhdimësi	Kom. për zgjedhjen e drejt. të shkoll.
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 40.2, pika b), c)	Prizren	6.2010	Rishikimi i buxhetit
Ligji mbi menaxhimin e financave publike	Neni 60.2	Prizren	23.09.2010	Miratimi i buxhetit
Ligji mbi menaxhimin e financave publike	Neni 45.4	Prizren	Në vazhdimësi	Raportet financiare tre mujore
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 58, pika j)	Prizren	Në vazhdimësi	Raportimi mbi gjendjen financiare
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 43.2	Prizren	Në vazhdimësi	Numri i seancave
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 40.2, pika a)	Prizren	01.06.2010	Ndryshimi i rregullores për tarifa
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	Neni 43.3	Mamushë	29.09.2010	Informimi i anëtarëve

Në tabelën e mësipërme është paraqitur në mënyrë kronologjike tabela me shkeljet ligjore të bëra nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit dhe të evidentuara nga KDI. Kuptohet se pjesë e kësaj table nuk do të mund të jenë të gjitha shkeljet ligjore të institucioneve në fjalë për shkak të pamundësisë për të pas çasje në të gjitha aktivitetet e komunave të këtij regjioni.



Nga tabela e mësipërme, fare qartë mund të shihet se Kuvendi i Komunës së Prizrenit prin me numrin më të madh të shkeljeve ligjore në krahasim me institucionet tjera simotra në Regjionin e Prizrenit.

#### • Arsyet e shkeljeve

Arsyet të cilat qojnë në shkelje të ligjeve në fuqi nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit mund të ndahen në tre kategori:

- \* Shkeljet ligjore të shkaktuara gjatë punës së kuvendeve;
- \* Shkeljet ligjore të shkaktuara si pasojë e bllokimit të punës së kuvendeve;
- \* Shkeljet ligjore të shkaktuara si pasojë e ndërhyrjes së kryetarëve të komunave në kompetencat e kuvendeve.

#### \* *Shkeljet ligjore të shkaktuara gjatë punës së kuvendeve*

Të kësaj kategorie mund të cilësohen shkeljet ligjore të bëra nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit gjatë mbledhjeve të rregullta apo të jashtëzakonshme të tyre. Në këtë kuadër mund të përmenden shkeljet ligjore të shkaktuara nga vonesa e konstituimit të institucioneve të pushtetit lokal, në informimin e publikut me aktivitetet e këtyre organeve etj.

#### \* *Shkeljet ligjore të shkaktuara si pasojë e bllokimit të punës së kuvendeve*

Të kësaj kategorie mund të cilësohen shkeljet ligjore të bëra nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit si pasojë e bllokimit për arsye të ndryshme të punës normale të këtyre institucioneve. Në këtë kuadër mund të përmenden mos përmbushja e obligimit ligjor për mbajtje të pesë seancave në gjashtë muajt e parë të vitit, mos raportimin para kuvendit mbi gjendjen financiare të komunës etj.

#### \* *Shkeljet ligjore të shkaktuara si pasojë e ndërhyrjes së kryetarëve të komunave në kompetencat e kuvendeve*

Të kësaj kategorie mund të cilësohen shkeljet ligjore të bëra nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit si pasojë e ndërhyrjes së kryetarëve të komunave në kompetencat e këtyre institucioneve. Në këtë kuadër mund të përmenden rishikimi i buxhetit, ndryshimi i rregulloreve, udhëheqja e seancave nga kryetarët e komunave etj.

#### • Çka duhet bërë?

Argumentet e ofruara në këtë dokument mbi shkeljet ligjore të bëra nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit, janë model i mirë për të matur dhe kuptuar shkallën e respektimit të ligjeve nga institucionet e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Ato, po ashtu, janë model i mirë për të kuptuar shkallën e angazhimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në funksion të përmbushjes së misionit zyrtar të saj "Avancimit të qeverisjes lokale, në bashkëpunim me strukturat e zgjedhura dhe zyrtarët komunal për të siguruar shërbime efektive në raport me qytetarët".

<sup>6</sup> <http://www.mapl-ks.org/?cid=1,6>

MAPL dhe kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit nuk kanë treguar pjekuri institucionale në funksion të sigurimit të ligjshmërisë në punën e organeve të vetëqeverisjes lokale. Krahas kësaj, institucionet në fjalë kanë treguar mungesë të theksuar kapaciteti, por edhe vullneti politik, gjithnjë me synim të ushtrimit të detyrave të tyre në përputhje të plotë me ligjet në fuqi.


Është prioritet i kohës që institucionet shtetërore të bëjnë hapa konkret me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë në punën e institucioneve të vetëqeverisjes lokale dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

- Institucionet qendrore, përkatësisht MAPL, duhet të rrisë kapacitete monitoruese dhe këshilluese për komunat e Republikës së Kosovës. Ajo duhet të angazhohet edhe në rritjen e kapaciteteve vetanake për shqyrtim të ligjshmërisë së akteve të institucioneve të pushtetit lokal.
- Institucionet lokale, duhet të rrisin kapacitetet e tyre në drejtim sigurimit të plotë të ligjshmërisë në të gjitha sektorët që janë në kompetencë të saj.

## PUNA E KUVENDEVE TË KOMUNAVE TË REGJIONIT TË PRIZRENIT

11

Gjatë periudhës Korrik – Shtator 2010, në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit janë mbajtur gjithsej 17 seanca. Dy nga këto mbledhje kanë qenë të jashtëzakonshme, njëra nga seancat është përsëritur me kërkesë të MAPL-së, ndërkaq mbledhjet tjera kanë qenë të rregullta.



Duke marrë parasysh se pjesë e kësaj periudhe kanë qenë edhe pushimet verore, kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit kanë treguar aktivitet solid në kuptim të mbajtjes së seancave.

Në kuadër të zbatimit të plotë të ligjshmërisë në punën e institucioneve në fjalë, vlen të theksohet se Kuvendi i Komunës së Prizrenit edhe më tej ballafaqohet me probleme të theksuara. Shqetësuese në këtë mes paraqiten shkeljet ligjore të vazhdueshme nga ky institucion.

Një tjetër burim të shqetësimit për punën normale të kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit paraqet edhe bojkotimi, në disa raste, i punës së këtyre organeve nga ana e subjekteve politike të opozitës. KDI konsideron se roli i të gjithë anëtarëve të zgjedhur të kuvendeve të komunave është përfaqësimi i interesave të qytetarëve dhe transmetimi i kërkesave dhe brengave të tyre në institucionet në të cilat janë zgjedhur. Andaj, përkushtimi maksimal në zbatimin e obligimeve ligjore dhe morale nga anëtarët e subjekteve politike do të ishte kontributi më i madh i tyre në drejtim të demokratizimit të mëtejshëm të shoqërisë sonë dhe do të sillte përfaqësim më dinjitoz të qytetarëve në organet e vetëqeverisjes lokale.

- **Përmbledhje nga seancat**

Në kuadër të monitorimit të punës së kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka vazhduar me monitorimin e punës së këtyre institucioneve edhe gjatë periudhës Korrik – Shtator 2010.

- **Prizren**

Kuvendin e Komunës së Prizrenit edhe muajt e fundit e kanë përcjellë me aktivitete të komplikuar të cilat shpesh janë karakterizuar edhe me shkelje ligjore. Në periudhën Korrik – Shtator 2010 ky institucion ka mbajtur katër seanca, njëra nga të cilat ka qenë përsëritje e një mbledhjeje të kaluar me kërkesë të MAPL-së dhe një seancë tjetër ka qenë e jashtëzakonshme.

Fillimisht më datë 08.07.2010 është ftuar seanca e veçantë me pikë të vetme të rendit të ditës, dhënien e betimit të dy anëtarëve të rinj të këtij organi, përkatësisht Masar Shala (PDK) dhe Pajtim Kosova (AKR) të cilët kanë zëvendësuar Xhemshit Krasniqin (PDK) dhe Fatmir Lipoveci (AAK). Përfundimi i kësaj pike është përcjellë me vazhdim të seancës së ndërprerë të datës 26.04.2010 dhe e cila ka dështuar të mbahet edhe më datën 08.06.2010 për shkak të mungesës së kuorumit. Gjatë kësaj seance, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit kanë marrë një sërë vendimesh. Është themeluar Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete, është marrë vendim për binjakëzim të Komunës së Prizrenit me Komunën e Osijekut të Kroacisë dhe Komunën Kushadasi të Turqisë, po ashtu është marrë vendim për shpalljen qytetar nderi të Komunës së Prizrenit të Kryeministrit të Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan dhe në fund është bërë edhe zgjedhja e Orhan Lloparit (KDTP) në pozitën e Nënkryetarit për Komunitete të Komunës së Prizrenit. Kjo seancë e Kuvendit të Komunës së Prizrenit është mbajtur pa u respektuar Neni 43 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale mbi informimin e anëtarëve të Kuvendit dhe të publikut. Në këtë kontekst MAPL ka kërkuar që Kuvendi i Komunës së Prizrenit në një seancë të veçantë t'i rishikojë të gjitha vendimet e mara në seancën e datës 08.07.2010.

---

**Kuvendi i Komunës së Prizrenit nuk ka vepruar në përputhje me Nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale sipas së cilës Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.**

---

Më datë 30.08.2010 në mbledhjen e saj të përsëritur, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka rikonfirmuar të gjitha vendimet e mara në seancën e datës 08.07.2010. Krahas kësaj, në këtë mbledhje Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka marrë edhe disa vendimet tjera si ajo për themelimin e Komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtorë të shkollave, vendimin për emërtimin dhe themelimin e drejtorive komunale, vendimin mbi rishikimin e buxhetit dhe vendimin për themelimin e Komisionit për persona me aftësi të kufizuara.

Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prizrenit të datës 17.09.2010 është bërë zëvendësimi i anëtarit Orhan Llopar (KDTP), të zgjedhur në postin

e Nënkryetarit për Komunitete, me anëtarin tjetër nga radhët e KDTP-së Enis Subi. Po në këtë mbledhje është diskutuar edhe mbi vendimin e Gjykatës Kushtetuese mbi shpalljen kundër kushtetuese të Nenit 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit që ka të bëjë me emblemën e Komunës së Prizrenit.

Seanca e fundit e Kuvendit të Komunës së Prizrenit brenda periudhës Korrik – Shtator është mbajtur më 23.09.2010. Kjo njëkohësisht ka qenë seanca më produktive e këtij organi prej se është themeluar ky institucion pas Zgjedhjeve 2009, megjithëse edhe kjo është përcjellë me shkelje ligjore. Në këtë seancë organi më i lartë i Komunës së Prizrenit ka marrë vendim mbi:

- Miratimin e Buxhetit për vitin 2011;
- Miratimin e Planit Rregullues Urban për zonën e veçantë për industri të lehtë “Parku i Biznesit”;
- Miratimin e Planit Rregullues Urban (PRrU) për zonën “Qendra e Re”;
- Ndryshimin e pjesërishëm të PRrU për zonën “Lakuriqi”;
- Hartimin e PRrU për pjesë tjera të qytetit;
- Lartësinë dhe mënyrën e caktimit të kompensimit në emër të tokës ndërtimore të shpronësuar në lagjen “Dardania”;
- Themelimin e Këshillit të Ekspertëve; dhe
- Është shqyrtuar Raporti vjetor i punës së Avokatit Publik Komunal.

---

**Kuvendi i Komunës së Prizrenit nuk ka përmbushur obligimin e saj ligjor për konsultim me publikun në përputhje me Nenin 60.2 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike me rastin miratimit të Buxhetit për vitin 2011.**

---

Në asnjërën nga katër seancat e mbajtura në Kuvendin e Komunës së Prizrenit gjatë periudhës Korrik – Shtator 2010 nuk kanë marrë pjesë anëtarët e këtij organi nga radhët e subjekteve politike të opozitës.

---

**KDI konsideron se është obligim i të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit pjesëmarrja në të gjitha mbledhjet e këtij organi në përputhje me Nenin 39.8 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.**

---

• **Suharekë**

14

Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë periudhës Korrik – Shtator 2010 ka mbajtur dy seanca.

Në seancën e datës 13.08.2010, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka marrë vendim mbi:

- Dhënien në shfrytëzim të pronës publike për ndërtim të ambulancës;
- Ndryshimin e vendimit mbi të hyrat dhe të dalat e buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2010;
- Bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2009 për shfrytëzim në vitin 2010; dhe
- Është shqyrtuar raporti mbi buxhetin komunale për periudhën Janar – Qershor 2010.

Seancën e saj të dytë brenda periudhës në fjalë, Kuvendi i Komunës së Suharekës e ka mbajtur më datë 27.09.2010. Në këtë mbledhje ky organ pos tjerash ka marrë vendim mbi:

- Zëvendësimin e anëtarëve të Komiteti për Politikë dhe Financa nga radhët e PDK-së, përkatësisht të Zymer Llugaxhiut dhe Shaban Gollopenit me Murtez Zekollin e Zoja Zenelajn;
- Miratimin e Rregullores për ndarje të banesave për familjet e dëshmorëve;
- Miratimin e Rregullores për tatimin në pronë; dhe
- Miratimin e Buxhetit për vitin 2011.

Në dy seancat e mbajtura në Kuvendin e Komunës së Suharekës ka pësuar ndryshim edhe fuqia e subjekteve të cilat janë të përfaqësuara në këtë organ. Fjala është për kalimin e Zymer Llugaxhiut (PDK) dhe Leonora Reshitajt (LDD) në subjektin e AAK-së duke bërë që ky subjekt të bëhet forca kryesore politike e Kuvendit të Komunës së Suharekës me 12 anëtarë.

- **Rahovec**

Gjatë muajit Korrik-Shtator 2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka mbajtur tri mbledhje. Në seancën e parë të datës 02.07.2010 janë trajtuar Raportet e Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Rahovecit për vitin 2008 dhe 2009 si dhe Raporti Financiar përfundimtar i Komunës së Rahovecit për vitin 2009. Ajo çka vlen të theksohet në këtë mes është se Kuvendi i Komunës së Rahovecit në këtë seancë ka formuar edhe një Panel intervistues për zgjedhjen e Drejtorëve të shkollave në Komunën e Rahovecit në përputhje me Ligjin për Arsimin Fillor në Komuna.

---

**Kuvendi i Komunës së Rahovecit nuk ka vepruar në përputhje me Nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale sipas së cilës Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.**

---

Seancën e dytë të mbajtur gjatë kësaj periudhe me 27.08.2010, e ka karakterizuar trajtimi i një sërë çështjesh me rëndësi jetike për qytetarët e Komunës së Rahovecit. Në mesin e shumë çështjeve që janë trajtuar në këtë seancë ishin vendimi mbi vërtetimin e interesit të përgjithshëm shoqëror për ndërtimin e Fabrikës për përpunimin e prodhimeve prej dheut në fshatin Fortesë, si dhe vendimi mbi vërtetimin e interesit të përgjithshëm për ndërtimin e Fabrikës për grumbullimin dhe përpunimin e perimeve në fshatin Krushë e Madhe.

Në seancën e tretë të mbajtur gjatë kësaj periudhe me 29.09.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka miratuar Buxhetin për vitin 2011 si dhe Rregulloren për tarifa në pronë.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2010 i është kthyer normalitetit për vetë faktin e trajtimit të shume çështjeve që janë me rëndësi jetike për qytetarët e kësaj komune. Megjithatë, anëtarët e Kuvendi të Komunës së Rahovecit duhet të jenë më këmbëngulës në drejtim të respektimit të dispozitave ligjore që kërkojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.



- **Malishevë**

Gjatë muajit Korrik-Shtator 2010, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur dy mbledhje. Në seancën e parë të mbajtur me 07.07.2010 është trajtuar Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Malishevës për vitin 2008/09.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet: a) data e mbajtjes së mbledhjes; b) koha e mbajtjes së mbledhjes; c) vendi i mbajtjes së mbledhjes; d) rendi i ditës për mbledhje; dhe e) materialet e mbledhjes. f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi Gjuhët. I njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut. Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale<sup>7</sup>.

Shqetësim i ngritur në këtë seancë nga ana e anëtarëve të opozitës pranë Kuvendit të Komunës së Malishevës ishte pikërisht mos njoftimi i Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal si organ mbikëqyrës të komunave.

Një gjë e tillë është raportuar edhe nga ana e Ministrisë gjegjëse për mos respektim të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Ka pasur raste kur ftesat në autoritetin mbikëqyrës (MAPL) nuk dërgohen fare (rasti të Komuna e Malishevës), dërgohen me vonesë, apo edhe kur ato dërgohen me kohë nuk kompletohen me materialet e nevojshme të mbledhjes<sup>8</sup>.

---

**Kuvendi i Komunës së Malishevës si organ më i lartë i vendimmarrjes me këtë rast ka bërë shkelje të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës i rekomandohet, që të respektoj dispozitat ligjore, me qëllim që Ministria si organ mbikëqyrës i komunave të jetë prezent në mbledhjet e këtij organi.**

---

Në seancën e dytë të datës 29.10.2010, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka miratuar Projekt Buxhetin për vitin 2011, ka shqyrtuar Raportin e punës gjashtëmuajore për vitin 2010 si dhe ka miratuar kërkesën e grupit parlamentar të LDK-së për formimin e Komitetit për Arsim dhe Kulturë.

Shqyrtimi i kërkesave të grupit parlamentar të LDK-së, si ajo për fillimin e propozim-ndryshimeve në Statutin e Komunës së Malishevës dhe fillimin e propozim-ndryshimeve në Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës nuk kanë gjetur mbështetjen e anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga radhët e pozitës dhe si të tilla nuk janë miratuar.

<sup>7</sup> Neni 43 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

<sup>8</sup> Raporti i monitorimit të komunave të Republikës së Kosovës, Janar-Qershor 2010, <http://maplks.org/repository/docs/raporti%20gjashte%20muajor%20shqip%20FINAL1.pdf>



- Dragash

Kuvendi i Komunës së Dragashit në periudhën Korrik – Shtator 2010 ka mbajtur gjithsej katër seanca. Megjithëse numri i seancave të mbajtura në këtë periudhë ka qenë relativisht i lartë dhe se njëra seancë ka qenë e jashtëzakonshme, numri i çështjeve të trajtuara nuk ka qenë i lartë.

Ndër çështjet e trajtuara nga ky institucion gjatë kësaj periudhe vlen të përmenden:

- Shqyrtimi i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2009;
- Konstituimi i Komiteti për Politikë dhe Financa;
- Konstituimi i Komiteti për Komunitete;
- Ndryshimi i Rregullores së Punës së Kuvendit;
- Miratimi Rregullores për tatimin në pronë; dhe
- Miratimi i Buxhetit për vitin 2011.

Krahas kësaj, puna e Kuvendit të Komunës së Dragashit gjatë kësaj periudhe është karakterizuar me ngritjen e një numri të madh të çështjeve nga anëtarë të këtij organi në kuadër të pikës së veçantë të rendit “Pyetje-Përgjigje”, pikë kjo e cila pas propozimit të KDI-së parashtrohet në çdo seancë të Kuvendit të Komunës së Dragashit.

Megjithatë, edhe në Kuvendin e Komunës së Dragashit janë paraqitur çështje të cilat paraqesin shqetësim për mbarëvajtjen në punën e këtij organi dhe në forcimin e demokracisë në këtë Komunë. Fjala është për vendimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Dragashit nga radhët e LDK-së për “bojkot të pjesërishtëm” të punës së organit më të lartë të Komunës së Dragashit, që nënkupton pjesëmarrje në seancë, mospjesëmarrje në diskutime dhe votim kundër për të gjitha çështjet që shtrohen për votim.

---

**KDI konsideron se asnjë mënyrë e bojkotit nuk do të duhej të ishte pjesë e praktikave parlamentare të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Dragashit. Andaj KDI fton anëtarët e të gjitha subjekteve politike të këtij organi që të veprojnë aktivisht në të mirë të zhvillimit të mëtejshëm të demokracisë dhe në të mirë të përfaqësimit të mirëfilltë të interesave të qytetarëve të Komunës së Dragashit.**

---

- **Mamushë**

Kuvendi i Komunës së Mamushës gjatë periudhës Korrik – Shtator 2010 ka mbajtur dy seanca të rregullta, atë të datës 30.07.2010 dhe 29.09.2010.

Disa nga çështjet e trajtuara nga ky institucion gjatë këtyre seancave kanë qenë:

- Miratimi i Rregullores për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare;
- Vendimi mbi shpalljen e Kryeministrit të Republikës së Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan dhe ushtarakut Jahja Baxhak, Qytetar Nderi të Komunës së Mamushës; dhe
- Miratimi i Buxhetit për vitin 2011.

---

**Gjatë punës së Kuvendit të Komunës së Mamushës, monitoruesit e KDI-së kanë evidentuar disa shkelje procedurale të cilat në instancë të fundit nuk kanë penguar funksionimin normal të këtij institucioni. KDI konsideron se do të ishte në dobi të organit më të lartë të Komunës së Mamushës, angazhimi i mëtejshëm dhe permanent në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të të gjitha palëve të kyçura në punët e institucionit në fjalë.**

---

## PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

Me qëllim të nxitjes së praktikave më të mira për pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen lokale do të analizohen rastet e mira dhe ato me negative; rastet e qeverive lokale në Regjionin e Prizrenit për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Konceptimi i demokracisë si mundësi me reale e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje nuk përkufizon edhe mundësin e realizimit të mekanizmave ligjorë që janë ofruar qytetarëve që të jenë pjesë në hartimin e politikave publike. Në këtë dokument do të trajtohet pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje nëpërmjet përdorimit të rasteve studimore nga Regjioni i Prizrenit me qëllim të të kuptuarit të konceptit të pjesëmarrjes së qytetarëve.

Edhe përkundër bazës ligjore të mjaftueshëm për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje është më se e theksuar mungesa e gatishmërisë së institucioneve lokale për të futur në agjendat politike të tyre për trajtim më serioz pjesëmarrjen e qytetarëve. Institucionet lokale akoma nuk e kanë të qartë se pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është një qelës për krijimin e qëndrueshmërisë së vendimeve politike dhe zhvillimin e demokracisë lokale. Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje akoma mbetet një sfidë në vete në qeverisjen lokale. Shumë nga zyrtarët e qeverive lokale të regjionit të Prizrenit proklamojnë politika si të hartuara me pjesëmarrjen e qytetarëve. Mirëpo shikuar nga këndvështrimi i mekanizmave ligjor që rregullojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim marrje mbete të kundërshtohen zërat e zyrtarëve që pohojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në hartimin e politikave publike.

Kreu i IX I Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka dhënë një dimension në drejtim të ndërtimit të mekanizmave ligjor në demokracinë e drejtpërdrejt dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Si mekanizma ligjor për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje Ligji për Vetëqeverisje Lokale parasheh: informimin e publikut dhe konsultimin, të drejtën e peticionit nga ana e qytetarëve, iniciativat e qytetarëve, referendumin, largimin e kryetarit si dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në komitetet konsultative<sup>9</sup>.

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka trajtuar me seriozitet qeverisjen lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike<sup>10</sup>. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton<sup>11</sup>. Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushë veprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmijë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj<sup>12</sup>.

<sup>9</sup> Kreu i IX i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

<sup>10</sup> Neni 45.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

<sup>11</sup> Ibid 52.2

<sup>12</sup> Ibid 79

- **Sfidat e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje**

Si indikator relevant për ngritjen e nivelit të demokracisë mund të jetë edhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje. Praktikrat e deritanishme në komunat e Regjionit të Prizrenit kanë treguar nivel jo të kënaqshëm të pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjimet publike dhe si rrjedhojë kemi edhe përcaktimin e prioriteteve në hartimin e politikave publike vetëm nga ana e udhëheqësve institucional pa pjesëmarrjen e domosdoshme të qytetarëve.

Zyrtarët komunal në anën tjetër kanë respektuar dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për organizimin e dëgjimeve publike. Të gjitha komunat në Regjionin e Prizrenit kanë mbajtur dëgjimet publike me qytetarë mirëpo në shumicën e këtyre dëgjimeve publike të organizuara nga qeveritë lokale kanë munguar pjesëmarrja e qytetarëve. Në shumicën e këtyre dëgjimeve publike nga ana e kryetarëve të qeverive lokale që përfaqësojnë komunat e Regjionit të Prizrenit janë prezantuar të arriturat e punës së dikastereve të tyre. Thënë konkretisht këto dëgjime publike janë shfrytëzuar më tepër për proklamim të aktiviteteve të qeverive lokale se sa në marrjen e imputit qytetarë apo kërkesave të tyre në drejtim të trajtimit sa më seriozë për lehtësimin e jetës së qytetarëve në lokalitete të ndryshme.

Në komunat e Regjionit të Prizrenit duhet bërë dallimi sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim marrje, ngase Komuna e Prizrenit dhe e Rahovecit nuk kanë respektuar fare udhëzimet që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Financat Lokale dhe Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike që rregullojnë çështjen e konsultimit publik dhe pjesëmarrjes së publikut në hartimin e politikave publike.

---

**Me këtë rast Kuvendi i Komunës së Prizrenit dhe ai i Rahovecit kanë bërë shkelje serioze të ligjeve në fjalë duke mos respektuar dispozitat ligjore mbi konsultimin e publikut me rastin e miratimit të dokumenteve më rëndësi për qytetarët e komunës.**

---

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) apelon po ashtu te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) që në të ardhmen të ndërmerri masat e nevojshme me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore të cilat rregullojnë çështjen e konsultimit dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset e politikë bërjes edhe në Komunën e Prizrenit dhe të Rahovecit.

Sidoqoftë, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore, mirëpo pjesëmarrës në këtë dëgjim publik më tepër kanë qene punëtorët komunal se sa qytetarë. Ajo çka mbetet shqetësuese në këtë komunë është se në këtë dëgjim publik është prezantuar Korniza Afatmesme buxhetore 2011-2013, pa listën e projekteve kapitale për vitin 2011 dhe pjesëmarrësit e kanë pasur të pamundshme që të kuptojnë më shumë rreth planeve për investime kapitale të pushtetit lokal.

---

**Me këtë rast Komuna e Malishevës ka bërë tentativë në respektimin e dispozitave ligjore mirëpo ky diskutim publik është tejet fiktiv ngase qëllimi i dëgjimit publik mbi Kornizën Afatmesme Buxhetore është që të merret inputi i qytetarëve në përcaktimin e prioriteteve të tyre për projektet kapitale në nivel lokal.**

---


Çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara. Njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal<sup>13</sup>.

Vlen të ceket se Kuvendet e Komunave të regjionit të Prizrenit në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisje lokale kanë mbajtur nga një dëgjim publik me qytetarë, ku kryesisht janë prezantuar të arriturat e qeverive lokale përkatësisht njoftim mbi punët e realizuara dhe ato në realizim rreth projekteve kapitale të realizuara në gjashtë mujorin e parë të vitit 2011.

## REALIZIMI I BUXHETEVE KOMUNALE NË GJASHTË MUJORIN E PARË 2010<sup>14</sup>

Ashtu sikurse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, edhe gjashtë komunat e Regjionit të Prizrenit, në bazë të kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, kanë të drejtë të posedojnë dhe menaxhojnë buxhetet vetanake. Në bazë të ligjit në fjalë, buxheti i komunave sigurohet nga grantet qeveritare, të hyrat vetanake, grantet për kompetencat e shtuara, grantet e jashtëzakonshme dhe forma tjera të para-para<sup>15</sup>.

Sipas kësaj, buxheti i komunave të Regjionit të Prizrenit është paraqitur grafikisht në tabelën e mëposhtme<sup>16</sup>.



Zhvillimi lokal ekonomik, ofrimi i shërbimeve publike, ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, ofrimi i përkujdesjes publike primare shëndetësore janë vetëm disa nga kompetencat me të cilat komuna është e ngarkuar. Këto çështje, në të njëjtën kohë, janë absorbueset më të mëdha të buxheteve të komunave.

<sup>13</sup> Neni 68.1 dhe 68.2 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.


<sup>14</sup> Pjesë nga Analiza Krahasuese, Maj 2010, KDI.

<sup>15</sup> Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Neni 7.

<sup>16</sup> Buxhetet e Komunave për vitin 2010 të miratuara në vitin 2009..

## o Shpenzimet e komunave në gjashtë mujorin e parë 2010

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna mbi realizimin e shpenzimeve të komunave të Regjionit të Prizrenit gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010.



Nga kjo mund të shohim se Komuna e Prizrenit, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka shpenzuar vetëm 19.7 % të buxhetit të paraparë për tërë vitin 2010. Komuna e Prizrenit, siç edhe shihet nga grafikoni, është komuna me nivelin më të ulët të realizimit të shpenzimeve të planifikuara për këtë vit në krahasim me komunat tjera të këtij regjioni. Kjo shifër në të njëjtën kohë tregon për stagnim të Komunës së Prizrenit në drejtim të realizimit të buxhetit në përputhje me planifikimet e bëra.

Në këtë segment prin Komuna e Malishevës e cila në gjashtë mujorin e parë të këtij viti ka shpenzuar 49.9 % të buxhetit të planifikuar për tërë vitin 2010. Kjo në të njëjtën kohë flet për një efikasitet të kësaj komune në realizimin e planit të paraparë për shpenzime gjatë këtij viti.


Krahas kësaj, komunat tjera të Regjionit të Prizrenit kanë një trend mesatar të realizimit të planeve të tyre përkatëse të shpenzimeve gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti në krahasim me planet e shpenzimeve për gjithë vitin 2010.

## o Të hyrat e komunave në gjashtë mujorin e parë 2010

Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, sikurse edhe ato të Regjionit të Prizrenit, buxhetin e tyre e plotësojnë edhe nga realizimi i të hyrave vetanake. Disa nga burimet e të hyrave vetanake të komunave mund të jenë taksat dhe tarifatat komunale, taksat për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste, taksa për automjete motorike, taksat administrative etj<sup>17</sup>.

Gjithnjë në bazë të kapaciteteve të secilës komunë për të siguruar të hyra vetanake, çdo komunë e Regjionit të Prizrenit ka hartuar planet përkatëse për shumën që synojnë ta sigurojnë nga të hyrat vetanake.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë hollësi mbi planifikimet e komunave të Regjionit të Prizrenit për sigurimin e të hyrave vetanake për vitin 2010 dhe realizimin e këtyre parashikimeve në përqindje për gjashtë mujorin e parë të këtij viti.



Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë, mund të shohim se Komuna e Suharekës ka arritur nivelin më të lartë të sigurimit të të hyrave të planifikuara për këtë vit. Kjo komunë, në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, ka arritur të inkasojë gjithsej 54.5 % të të hyrave të planifikuara për gjithë vitin 2010.

Në këtë segment Komuna e Mamushës është në gjendje të palakueshme, pasi gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka arritur të inkasojë vetëm 19.7 % të të hyrave të planifikuara për gjithë vitin 2010.

<sup>17</sup> Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Pjesa II.




Instituti Demokratik i Kosovës i bën apel të gjithë qytetarëve të secilës komunë, që të jenë në nivel të përgjegjësive të tyre dhe si qytetarë të ndërgjegjshëm t'u përgjigjen institucioneve shtetërore në kryerjen e obligimeve ligjore.

Komuna e Prizrenit dhe ajo e Rahovecit duhet të tregojnë aktivitet të shtuar në periudhën e ardhshme me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar të komunave përkatëse dhe realizimit të planeve vetanake për investime kapitale.

### o Bilanci gjashtë mujor i komunave

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përmbledhja me krahasimin në mes shpenzimeve të realizuara nga komunat e Regjionit të Prizrenit gjatë gjashtë mujorit të parë 2010 dhe suksesit të treguar nga këto komuna në inkasimin e të hyrave vetanake të planifikuara për gjithë vitin 2010.



#### Shënim:

Shpenzimet komunale të paraqitura në tabelë janë llogaritur mbi bazën e buxhetit total të paraparë për secilën komunë për vitin 2010 dhe realizimit të tyre në periudhën gjashtë mujore të këtij viti. Të hyrat e paraqitura shfaqin përqindjen e realizimit gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti, të planeve të secilës komunë për të hyrat vetanake të planifikuara për gjithë vitin 2010.

Sipas kësaj:

26

- Komuna e Prizrenit, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010, ka realizuar 19.7 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 37.6 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Suharekës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010, ka realizuar 33.7 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 54.5 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Rahovecit, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010, ka realizuar 33.1 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 37.8 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Malishevës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010, ka realizuar 49.9 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 44.1 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Dragashit, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010, ka realizuar 36.4% të shpenzimeve dhe ka inkasuar 43.5 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Mamushës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010, ka realizuar 41.1% të shpenzimeve dhe ka inkasuar vetëm 19.7 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.

\* \* \* \* \*





**Përkrahur nga / Supported by:**

---